



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

KRYETARI

Nr. 216 Prot.

Patos, më 19 / 01 /2026



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 05, datë 19 . 01 .2026

PËR DISA NDRYSHIME NË V.K.B NR. 77, DATË 27.11.2025 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE NË BASHKINË PATOS DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të shkronjës "ç" të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 5 dhe neni 9 i ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve institucioneve të administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", V.K.M-së nr. 328, datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar me V.K.M-në nr. 503, 01.08.2024 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026" V.K.M-në nr. 776, datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi",

KËRKOJMË:

1. Të miratojë ndryshimin e nivelin të pagës minimale për punonjësit e Bashkisë Patos, Ndërmarrjeve në varësi dhe Sekretarit të Këshillit Bashkiak, kategoria II-2, sipas relacionit në të cilin është përcaktuar numri i punonjësve sipas njësive shpenzuese.
2. Efekti financiar do të fillojë prej datës 1 Janar 2026, do të përballohet nga shtesa e Grantit për vitin 2025, fondi kontigjencës, fondi rezerv dhe planit të Buxhetit 2026 për "Shpenzime personeli".
3. Pas miratimit të këtij projekt vendimi ngarkohen për zbatim Drejtoria e Financës Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve, Pastrimit dhe Gjelbërimit.

GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Sokol Meta

Mimoza Shtëmbari

Boreta Murati

Ina Sauli

Juela Shpata

Çajup Refitaj

Mitjon Nikolla

Alket Halimi

Eneo Xhaferi

Arben Shpërdheja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 216/1 Prot.

Patos, më 19.11 /2026

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN "PËR DISA NDRYSHIME NË V.K.B NR. 77, DATË 27.11.2025 PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE NË BASHKINË PATOS DHE NËRDMARRJEVE NË VARËSI PËR VITIN 2026".

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim bazohet në V.K.M-në nr. 776, datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" dhe është i domosdoshëm për të përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në shkronjës "ç" të nenit 54 të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ku shprehet se Këshilli i Bashkisë "miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi".

Bashkia Patos në total ka 380 punonjës e miratuar me V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026" dhe përbëhet nga tre njësi shpenzuese, nga të cilët 144 punonjës do të përfitojnë nga ndryshimi i pagës minimale:

- Bashkia e cila ka 211 punonjës, 14 punonjës do të përfitojnë nga ndryshimi i pagës minimale.
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka 105 punonjës, 72 punonjës do të përfitojnë nga ndryshimi i pagës minimale.
- Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve, Pastrimit dhe Gjelbërimit ka 64 punonjës, 58 do të përfitojnë nga ndryshimi i pagës minimale.

Të gjithë punonjësit administrative, përveç pagës bazë përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1% mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme, por jo më shumë se 25 vjet.

Ndryshimi i pagës së Sekretarit të Këshillit Bashkiak, kategoria II-2 në shtesën e pozicionit 140 000 (njëqind e dyzet mijë) lekë, bëhet për t'u njëhësuar me pagën e drejtorave të drejtorive në Bashkinë Patos e bazuar në V.K.M-në nr. 503, 01.08.2024 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Për sa më sipër ftojmë Këshillin e Bashkisë Patos që të miratojë këto ndryshime të nivelit të pagave të propozuar nga ekzekutivi.

DREJTOR

Juela Shpata

ZËVENDËSKRYETAR

Ina Sauli

